



Prishtinë, 27 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1437_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin të ngarkesave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes;
- Metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes;
- Vendimin V_1423_2021 të datës 7 tetor 2021 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Kërkesën/aplikacionin e KEDS-it për miratimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 15 tetor 2021,

në seancën e mbajtur më 27 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), aplikohen nga data 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- II. Struktura e tarifave SHSSH që zbatohet nga OSSH (KEDS SH.A), është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

| Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të OSSH | | |
|--------------------------------------------|--------|--------|
| Niveli i tensionit | Njësia | Tarifa |
| 35 kV | €/kWh | 0.90 |
| 10 kV | €/kWh | 1.31 |
| 0.4 kV | €/kWh | 2.10 |

ARSYETIM

- ↘ ZRRE më datë 15 tetor 2021 ka pranuar nga KEDS Sh.A, kërkesën/aplikacionin për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes. Propozimi i KEDS SH.A për tarifat e OSSH-së është i bazuar në vendimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale V_1423_2021. Tarifat e propozuar nga KEDS SH.A janë kalkuluar në pajtueshmëri me Metodologjinë për përcaktimin e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes.
- ↘ Tarifat e propozuara nga KEDS SH.A, reflektojnë kostot e shërbimit për nivelet përkatëse të tensionit.
- ↘ ZRRE me rastin e vendosjes së Tarifave SHSSH të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS), ka marrë parasysh dokumentet e përgatitura, lëshuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:

- Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Shpërndarjes – KEDS SH.A (OSSH) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 8 mars 2021 në ZRRE;
- Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
- Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
- Komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes KEDS Sh.A. (OSSH) ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 7 shtator 2021.
- Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar 8 tetor 2021.
- Vendimin V_1423 _2021 të datës 7 tetor 2021 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, do të zbatohet nga KEDS SH.A., duke filluar nga data 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfiye Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A),dhe
- Arkivit të ZRRE-së.